



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.191, datë 12.07.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. **Zoti Moisi Duda**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Zoti Moisi Duda, do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nga data 24.07.2022 - 23.10.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Moisi Duda do të paguhet me pagën e pozicionit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Moisi Duda, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 12.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Mirela Bogdani